

VENDIM

Nr. 906, datë 17.12.2014

PËR SHPËRBLIMIN DHE KOMPENSIMIN E DISA KATEGORIVE TË VEÇANTA PËR FESTAT E FUNDVITIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të neneve 10 e 13, të ligjit nr. 185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Arsimit dhe Sportit i shtohet fondi prej 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekësh, në zërin shpenzime korrente, për shpërblimin, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë, për kategoritë:

a) Nxënës me rezultate të shkëlqyera në ciklin e dytë të sistemit 9-vjeçar dhe të mesëm, në arsimin publik;

b) Studentë të ekselencës, në arsimin e lartë publik.

2. Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë i shtohet fondi prej 661 000 000 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një milionë) lekësh, në zërin shpenzime korrente, për kompensimin financiar për kategoritë e veçanta, si më poshtë vijon:

2.1 Në masën 3 000 (tre mijë) lekë, për kategoritë:

a) Familje, të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike;

b) Familje, që kanë në përbërje të tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë, me vendim të KMCAP-së, sipas pikës 3, të nenit 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore";

c) Individë, përfitues të statusit, sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar;

ç) Individë, përfitues të statusit, sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar.

2.2 Në masën 2 000 (dy mijë) lekë, për kategoritë:

a) Persona që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti dhe pension familjar, sipas ligjeve nr. 4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", dhe nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

b) Persona që marrin pension, sipas ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972, "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë" dhe sipas paragrafit të katërt, të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

c) Persona që marrin trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 8685, datë 22.6.2000, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë", të ndryshuar, si dhe personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarje të industrisë ushtarake", të ndryshuar;

ç) Persona që marrin pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

2.3 Në masën 3000 (tre mijë) lekë, për kategorinë e pensionistëve kryefamiljarë që, aktualisht, trajtohen me kompensim për energjinë elektrike, sipas vendimit nr. 565, datë 2006, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

2.4 Në masën 5 000 (pesë mijë) lekë, për kategorinë e veteranëve të LANÇ-it.

2.5 Në masën 5 000 (pesë mijë) lekë, për kategorinë e ish-të përndjekurve politikë, që, aktualisht, janë mbi moshën 65 vjeç.

3. Kategoritë e përcaktuara në pikat 2.3, 2.4 dhe 2.5, të këtij vendimi, përfitojnë vetëm njërin nga kompensimet e parashikuara në këtë vendim. Ministri i Financave përcakton mënyrën e pagesës.

4. Ministrisë së Punëve të Brendshme i shtohet fondi prej 2 200 000 (dy milionë e dyqind mijë) lekësh, në zërin shpenzime korrente, për shpërblimin e familjeve të policëve të rënë në detyrë, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

5. Ministrisë së Mbrojtjes i shtohet fondi prej 1 800 000 (një milion e tetëqind mijë) lekësh, në zërin shpenzime korrente, për shpërblimin e familjeve të ushtarakëve që janë në detyrë në misionet ushtarake jashtë vendit, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

6. Efekti financiar prej 1 800 000 000 (një miliardë e tetëqind milionë) lekësh, i këtij vendimi, të përballohet, në masën 700 000 000 (shtatëqind milionë) lekë, nga fondi i kontingjencës, parashikuar në buxhetin e vitit 2014, dhe 1 100 000 000 (një miliardë e njëqind milionë) lekë, nga fondi i kompensimit për

shtresat në nevojë, parashikuar për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

7. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes për detajimin e fondeve, sipas strukturës përkatëse buxhetore dhe përcaktimin e procedurës së dhënies së shpërblimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

KËRKESË

Shtetasja Syrina Muçaj kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, shpalljen e zhdukjes së babait të saj, shtetasit Skënder Meçe, i datëlindjes 25.2.1960.

KËRKUESJA

Syrina Muçaj

